



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.51, datë 28.09.2007.

**PËR
NGRITJEN E INSPEKTORATIT NDËRTIMOR E URBANISTIK PRANË
BASHKISË SË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, datë,31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, gërma ç, Ligjit Nr.9780,datë 16.07.2007”Për Inspektimin e Ndërtimit“, neni 4 dhe 18, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I:

1. Të miratojë ngritjen e Inspektoriatit Nëntimor e Urbanistik pranë Bashkisë së Tiranës, sipas strukturës, numrit të punonjësve të përcaktuara në Organigramë si dhe nivelin e pagave sipas **Lidhjes Nr.11**, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Efektet financiare të pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të mbulohen nga fondet e miratuara për paga dhe sigurime shoqërore të Aparatit të Bashkisë për vitin 2007.
3. Të miratojë një shtesë prej 10.000.000 lekësh në buxhetin e miratuar të Aparatit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007 në zërin “Shpenzime operative “ për Inspektoriatin Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë së

Tiranës duke reduktuar Buxhetin e miratuar të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit në zërin “shpenzime operative” në shumën prej 3.000.000 lekësh dhe Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit në zërin “shpenzime operative” në shumën prej 7.000.000 lekësh.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, Drejtoria Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R